



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja Nr. 02
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 30 dhjetor 2014, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Fikrim Damka, Hatim Baxhaku.

Stafi mbështetës i Komisionit: Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 22.12.2014;
3. Plani i punës për muajin e ardhshëm;
4. Të ndryshme.

***Kryetarja,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë: 22.12.2014;

Flora Brovina – në pjesën e fundit të procesverbalit në vend të fjalës “betim” të ndryshohet në “zotim” si dhe riformulim i fjalisë, “zotimin dhe deklarimin e dhëne që gjatë punës do të kemi një bashkëpunim me të mirë” si dhe në rendin e tretë fjala “me shumë” zëvendësohet “me që”. Time Kadrijaj, në fjalinë e fundit të deklarimit tim në vend të fjalisë “në menaxhimin dhe inspektimin shëndetësor” zëvendësohet me fjalinë “drejtoresh në inspektoratin shëndetësor”.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me datë: 22.12.2014 me vërejtje.

3. Plani i punës për muajin e ardhshëm;

Flora Brovina, tha se edhe mbledhjen e kaluar biseduam se ne si Komision duhet të kemi një plan të punës, mirëpo nuk mund të përgatisim planin e punës para se ti ndëgjojmë ata që i monitorojmë realisht dy ministrat përkatës atë të Ministrisë së Shëndetësisë si dhe Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, unë mendoj se muajin Janar të mos e humbim mirëpo të mbajmë mbledhje gjatë muajit janar dhe ti ftojme ministrat në takim. Unë kam biseduar me të dy ministrat dhe ata kanë pranuar se do të marrin pjesë në takimin që do ti ftojme dhe besoj se kanë mjaft kohe që pas datës: 19 ose 20 Janar që të përgatiten dhe që para nesh të na prezantojnë planin e tyre të punës për ministratë e tyre përkatëse. Mandej pas kësaj si dhe pas ardhjes së programit legjislativ të qeverisë ne si komision do të përgatisim planin e punës së komisionit.

Pra për këtë mbledhje propozoj që gjatë muajit të ardhshëm të kemi takime ndaras me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe me Ministrin e Shëndetësisë.

Po ashtu është një temë aktuale që ne si komision mund të trajtojmë nëse edhe ju jeni të pajtimit, unë po propozoj pra “çështja e shpërnguljes së popullatës masovikisht nga Kosova për shkaqe ekonomike”, atëherë nëse edhe ju pajtoheni këtë çështje mund të diskutojmë përmes organizimit të një tryeze të hapur dhe bashkërisht do të vendosim edhe për panelistët dhe mysafiret se kush mund të jenë pjesë e kësaj tryeze.

Time Kadrijaj, faleminderit kryetare, edhe unë jam e pajtimit që ne si komision që ti vendosim kontaktet e para me Ministrat përkatës ne si komision mundemi me ju ofruar bashkëpunim aq sa kemi kompetenca dhe sa mundemi, besojmë se edhe ata do të shprehin gatishmërinë e bashkëpunimit me komisionin përndryshe ata kanë edhe obligim që para komisionit të vijnë edhe të raportojnë për punën e tyre që bëjnë nëpër ministratë përkatëse po ashtu detyrë e jone si deputet edhe e komisionit është që të bëjmë monitorimin e këtyre dy ministrave. Edhe gjatë mandatit të kaluar çdo herë ministrat i janë përgjigjur ftesës së komisionit ku është diskutuar për çështje të caktuara. Është mirë se ne si komision të analizojmë situatën dhe siç ishte propozimi i kryetares ne si komision të marrim iniciativën dhe të organizojmë një tryeze, lidhur me çështjen e shpërnguljes së popullatës nga Kosova pse jo edhe organizimin e tryezave tjera për probleme të caktuara qoftë të shëndetësisë apo çështjeve sociale.

Njomza Emini, fillimisht unë pajtohem me propozimet tuaj, konsideroj se mese e nevojshme është që ne si komision të përgatisim planin e punës se si do të funksionojmë normalisht kjo nuk është e mundur që të behët para se me ardhë programi legjislativ, e dyta pajtohem me organizimin e tryezës pasi që aty mund të dalin edhe rekomandime të ndryshme nga përfaqësues të organizatave qeveritare por edhe të institucioneve tjera që ne si komision ashtu siç tha deputetja Kadrijaj të bashkëpunojmë bashkërisht dhe jo të kemi vetëm rolin mbikëqyrës por edhe të bashkëpunojmë se kështu s’bashku mund të arrijmë suksese me ministratë përgjegjëse. Po ashtu pajtohem që edhe dy ministrat përkatës që ti ftojme në takim edhe pse ata e kanë obligim që të raportojnë për punën dhe planet që i kanë si ministri përgjegjës, konsideroj se ka shumë çështje që mund ti trajtojmë ne si komision. Unë konsideroj se njëra nga çështjet mund të ishte që mjetet që ndahen nga zyra e kryeministrit për disa kategori për shembull për të verbrit dhe kategoritë tjera konsideroj se këtu mund të jenë në një buxhet dhe të mos behët një diskriminim dhe të ju jepet ndihma vetëm një kategorie për çështje të interesave apo për çështje tjera, këtu konsideroj se gjatë takimeve që do t’i kemi me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale të diskutojmë lidhur me këtë çështje, unë kam biseduar me ministrin në një takim që kam pasur i

cili po ashtu potencoi se mund të këtë probleme apo pa rregullsi në këto çështje, andaj kjo do të ishte mire që të jetë edhe njeri nga prioritetet tona si komision dhe të shohim se ka po shkojnë ato mjete, me sa duket ishte një problem tek ligji në fuqi pasi që ndihmat që ishin të parapara për këto kategori ishin të shpërndara dhe si çështje nuk ishte e rregulluar e mirë andaj ndoshta në këtë rast ju deputete znj. Kadrijaj mund të na elaboroni me tepër se si është e rregulluar me ligj.

Time Kadrijaj, tha se ne si komision mund të marrim nisme për monitorimin e një Ligji kur kemi informata se nuk është duke u implementuar se si duhet apo ka ngecje gjatë implementimit të tij dhe mund të caktohet një grup punues prej disa deputetëve i cili ka me u marre me monitorimin e ati ligji. Gjatë monitorimit të ligjit të caktuar në si komision e përgatisim një raport me konstatime dhe rekomandime mandej raporti diskutohet në kuvend dhe miratohet kurse rekomandimet që miratohen janë obligative për ministrinë përkatëse dhe është e obliguar që ti implementojë ato rekomandime.

Flora Brovina, tha se sa i përket tryezës nëse pajtoheni që të mbajmë pasi ta kemi një takim me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të caktojmë se kënd mund të ftojë në tryezë sigurisht kjo do të mbahet mbas takimit me ministrin dhe të shohim se cila është problematika të cilin besoj se do të prezantoj ministri në takimin që do të kemi. Po ashtu si komision bashkërisht do të diskutojmë se kush do të ftohet në këtë tryezë se çfarë formati do të organizohet se kush do të jenë panelist. Ne që kemi punuar edhe me herët në këtë komision i njohim organizatat jo-qeveritare dhe subjektet tjera të cilat merren me çështjen e punësimit të cilat do të ftohen në tryezë.

Shukrije Bytyçi, faleminderit kryetare përshëndetje për të gjithë anëtarët tjerë të komisionit. Unë pajtohem me para folësit tjerë që duhet që të organizohet një tryezë lidhur me çështjen e emigrimit të qytetareve tan. Unë kisha me theksu se si çështje që mund të diskutohet me ministrin e Shëndetësisë është edhe çështja e mos funksionimit të aparatit të Mamografisë. Unë i përgëzoje gratë deputete për iniciativën dhe me të vërtetë është bërë një punë e madhe. Edhe unë pajtohem që sa më shpejt të ftojë ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale për shkak se ka shumë probleme siç u theksua se ka shumë persona që janë pjesë e asistencës sociale dhe nuk e meritojnë dhe ka shumë persona tjerë që kanë nevojë për të qenë pjesë e skemave sociale dhe nuk janë përfitues edhe pse e meritojnë

Flora Brovina, aparati i mamografisë është blerë me iniciativën e grupit të grave deputete ku përveç neve si komision njëherit kanë të drejtën edhe grupi i grave deputete kanë të drejtën që të monitorojnë këtë çështje dhe të ftojnë ministrin në takim po ashtu edhe të realizojnë vizita në terën me pa persë afërmi se a po funksionon dhe si po funksionon dhe apo zbatohet plani që është parapare për mamografin mobil.

Besa Baftiu tha se, unë kisha me u kyçe të kjo çështja e mamografit mobile unë ja kam bërë një pyetje parlamentare ministrit të shëndetësisë lidhur me Mamografin mobil pasi që në momentin që ju është dorëzuar Ministrisë së Shëndetësisë ata janë kompetent me tej sa i përket funksionimit të tij, besoj se ministri do të përgjigjet në pyetjen parlamentari pasi që në këto dy seancat në rend dite ka qenë çështja e buxhetit dhe s'ka pasur rastin të përgjigjet, besoj shumë se në seancat e ardhshme do të përgjigjet se cilat veprime janë ndërmarre ndaj atyre që e kanë dëmtuar aparatin e mamografise apo veprimet që i kane ndërmarre për funksionalizimin e tij.

Time Kadrijaj, tha se nëse me lejohet kisha propozuar që në të ardhmen e afërt të organizojmë një takim me organizata OJQ-të, sindikata dhe organizatat tjera të cilat merren me çështjet

shëndetësorë dhe sociale që të ju shprehim gatishmërinë tonë për bashkëpunim dhe bashkërisht me ta ti shqyrtojmë mundësitë e bashkëpunimit tonë.

Fadil Beka, faleminderit kryetare, përshëndetje të gjithëve. Edhe unë pajtohem me të gjitha ato që u thanë sa i përket ftesës së ministrave mirëpo për veç kësaj unë konsideroj se në çdo situatë urgjente apo akute që paraqitet ne si komision të reagojmë me kohe pasi që janë dy sektor të ndjeshëm dhe nga ne qytetaret presin shumë e në veçanti punëtorët shëndetësor. Edhe unë pajtohem për organizimin e tryezave të ndryshme për probleme të caktuar ku përveç ministrit që do të ftohet të ftojme edhe panelist tjerë që janë të ndërlidhur direkt me problemin personat që udhëheqin me atë institucione ku do të diskutohet për të pasi që ai konsideroj se është i njoftuar me persë afërmi me problemin. Po ashtu të organizojmë edhe vizita nëpër teren nëpër të gjitha qendrat spitalore. Njëkohësisht duhet të kemi një bashkëpunim me sindikatat e ndryshme si ato shëndetësore edhe ato të punës me qëllim që të kemi një bashkëpunim të mirëfilltë gjatë punës sonë.

Kryetarja, konstatoi se komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këto:

Përfundime:

- Komisioni parimisht vendosi që mbledhjet të mbahen gjatë të mërkurave në ora 10. Kurse mbledhja e radhës të mbahet me datë: 21.01.2015, e Mërkure ora 10:00.
- Gjatë muajit Janar të ftohën ministrat në takime ndaras me Komisionin, takimi do të jetë i karakterit njoftues dhe njeherit të prezantimit të planit apo objektivave të tyre të punës në ministratë e tyre përkatëse.
- Organizimi i tryezës teme diskutimi “Çështja e shpërnguljes së popullatës nga Kosova për shkaqe ekonomike”, e cila do të organizohet mbas takimit me ministrat.

Kryetarja, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA